ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

A N K E S Ë

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA FUSHË KOSOVË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**612-24-1030-5-2-1**
Nr i brendshëm	**612 24 001 521**

Sa i përket tenderit për : **Rregullimi i hapësirës publike te QMF-ja dhe Kompleksi 300 në rrugët 28 Nëntori dhe Kuvendi i Lezhës në Fushë Kosovë**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"VALDRINI SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

DRENAS
(Adresa)

DRENAS
(Vendi)

13 000
(Kodi postar)

+383-49-623-188
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

QËNDRIM KURRUMELI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

valdrini.shpk@hotmail.com
(Adresa elektronike)

25/03/2024
(Data e parashtrimit të kërkesës)

Q.Kurrumeli
(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: **N/A**

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues – **KOMUNA FUSHË KOSOVË**, me date 30.05.2023 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: : **Rregullimi i hapësirës publike te QMF-ja dhe Kompleksi 300 në rrugët 28 Nëntori dhe Kuvendi i Lezhës në Fushë Kosovë,Me nr. Te prokurimit: 612-24-1030-5-2-1** si në vijim:

1. Procedurë e hapur,
2. Kontrate publike,
3. Punë, Vlerë e madhe
4. Vlera e parashikuar e kontratës: **115,000.00 euro**
5. Kriteri për dhënie të kontratës: **Çmimi me i ulte i tenderit të përgjegjshëm!**

Afati i fundit për dorëzim te tenderëve, ka qen me date **05.03.2024** ora:13:30,
Vendi: Zyra e Prokurimit
Takimi për hapjen e tenderëve ka qen me datë **05.03.2024** ora:13:30 ne platformën elektronikë te prokurimit.

Me date 11.03.2024 është publikuar B58 Vendimi i Autoritetit Kontraktues per dhënie te kontrates dhe letrat standarde për tenderuesit e pasuksesshem.
Bashkëngjitur ne këtë titull të këtij njoftimi kemi pranuar njoftimin për B42 Letrën standarde te tenderuesit te eliminuar.
Me date 16.03.2024 kemi bere kerkese per rishqyrtim pranë komunes së Fushë Kosovës
Me date 20.03.2024 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkeses për rishqyrtim si të pa bazuar.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja e tenderit është bërë në mënyrë elektronike në vendin e caktuar dhe ne kohen e caktuar, me 05.03.2024 në ora 13:30 h. Nuk kemi vërejtjeje!

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pa kënaqur me Vendimin e AK- Autoriteti kontraktues – **KOMUNA FUSHË KOSOVË** dhe në pajtim me nenin 108A të LPP-së parashtrojmë Ankesë kundër;

- **Njoftimit për eliminimin (Letrën standarde për tenderues te pasuksesshem) nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit.**
- **Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës : 20.03.2024**

Me date 16.03.2024 kemi bere kerkese per rishqyrtim pranë komunes së Fushe Kosoves
Me date 20.03.2024 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkeses pe rishqyrtim si të pa bazuar.

Prandaj te pa kënaqur me Vendimin e AK-Autoritetit kontraktues-komuna Fushë Kosovë, Për shkak të shkeljeve të dispozitave të;

- Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

- Nenin 1, Qëllimi, par 1 dhe 3.
- Nenin 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1.
- Nenin 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6
- Neni 10, Qasja në dokumentacion
- Nenin 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, par 1, nen par 1.1 ; 1.2 dhe par 3.
- Nenin 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 2 dhe 4
- Nenin 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1
- Nenin 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, par 1.
- Nenin 72 të LPP-së, të Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, par 1 dhe 2.

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Nenin 38, Sqarimi i Tenderëve, par 38.1
- Nenin 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a; b dhe c
- Nenin 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen (d) dhe (o)

III. Dispozitat e Udhëzuesit nr. 01/2023 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi UA2) dhe atë:

- 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

- Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore: **Sa i përket Formulari Letrës standarde për tenderues te PASUKSESSHEM.**

E kundërshtojmë në tërësi vendimin e AK lidhur me letrën standarde për tenderues te eliminuar, për faktin se arsyetimi i AK sa i përket eliminimit të ofertës tonë është i pa bazuar dhe në shkelje të kërkesave te përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT dhe në shkelje të dispozitave Ligjore të LPP-së.

Pretendimi i parë : Është shkelë Neni 1, Qëllimi, par 1 dhe 3.

-Sepse, nuk na është dhënë qasja e plote në dokumentacionin e të rekomanduarit për fitues sepse ne diten qe kemi marrur qasje nuk na eshte dhënë vlersimi i rriskut (valid) i kerkuar me sqarime nga AK per GOE te shpallur fitues, por vetem vlersimi i rriskut (jo valid) i dorzuar ne diten e ofertimi.

Pretendimi i dytë: Ne dosjen e tenderit te pika 9.1 & 9.2 te kapaciteti teknik dhe profesional pika 5. OE duhet te ofroj vleresimin e riskut nga nje kompani e licencuar nga MPMS , sipas Ligjit Nr.04L 161 per siguri dhe shendet ne pune dhe certifikatat per siguri dhe shendet ne pune per stafin profesional dhe punetoret.
Dëshmia e kerkuar dokumentare : 5. Deshmi -kopja e certifikates per siguri dhe shendet ne pune e noterizuar nga origjinali per stafin profesional dhe per punetoret e angazhuar ne kete projekt. Po ashtu kopja e licences se OE-se e cila e ka kryer vleresimin e riskut se bashku me raportin e vleresimit nga kompania e licencuar nga MPMS-ja.
-Pretendimi i parë: Ne bazë te dokumenteve te ofruara ne ofertën e dhënë **GOE : AAB Construction SH.P.K & Construmax shpk** , perkatesisht antari i grupit CONSTRUMAX SH.P.K ka ofruar vlersimin e rriskut te cilin e ka kryer te kompania **HSK L.L.C – Prishtinë** . Ky vlersim i rriskut është bërë me datën :**15.06.2019** ,ketij vlersimi të rriskut i ka kaluar afati (nuk ka validitet) sepse ne bazë të rregullores **02/2021** per vlersimin e rriskut neni 15 i rregullores pika 1: Tregon qartë qe vlersimi i rriskut duhet te rishikohet ne çdo dy vite , qka nenkupton qe vlersimi i rriskut i ofruar nga kompania Construmax shpk nga data **15.06.2021** nuk ka validitet, pra ketij dokumenti i ka kaluar validiteti

Pretendimi i tretë : AK ne vendimin mbi refuzimin e kerkeses tonë per rishqyrtim thote se i kemi kerkuar sqarime shtesë GOE AAB Construction shpk & Construmax shpk ku nga i njejti kemi pranuar Raportin perfundimtar te rishikimit te vlersimit te rriskut ne vendin e punes te dates 01.06.2023 dhe i njejti deshmohet nga AK por i mungon Noterimi pasi qe ky vlersim i rriskut ka qenë i noteruar para dates se ofertimit dhe i njejti nuk ka mundur qe te noterohet pas dites se ofertimit.
Përfundimishtë është shkelë Neni 10. i Udhëzimit Operativ, Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, sepse nuk lejohet të kqëpërdoret neni **72 pika 3 dhe nenin 59 pika 2** të LPP-së të kërkohet sqarime për një dokument i cili është ofruar me afat të skaduar.
Neni **59 pika 2 dhe Neni 72 pika 3**, kërkohet në rastet, citojmë:**"Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive".**

Pretendimi i katërt: Ne bazë te paramases dhe parallogarise te ofruara ne ofertën e dhënë **GOE : AAB Construction SH.P.K & Construmax shpk** , te pjesa III e paramases (Mbushja,rregullimi i hapesires dhe punet e asfaltit) ,perkatesisht pikat 7 dhe 8 , GOE ka ofruar dy qmime te ndryshme te asfaltit për trashesi ne 1 cm ,

Te pika 7. Punimi i shtreses se asfalt-betonit AB16 , trashesia t= 7cm ka ofruar qmimin 11 € qe

i bie 1.57 €/cm

Ndersa te pika 8. Punimi I shtreses se asfalt-betonit AB11 , trashesia t= 5cm ka ofruar qmimin 7 € qe i bie 1.40 €/cm , ketu kemi nje kontra ndryshim te qmimeve per 0.17 € (12%) , pasi qe qmimet e asfaltit ne treg janë : per Lloje te asfaltit me fraksione me te medha janë më të lira ndersa per Lloje te asfaltit me fraksione me te vogla jane me te shtrenjeta pasi qe sasia e bitumenit eshte me e madhe per fraksione me te vogla dhe qmimi i zhavorit me te vogel eshte me i madh.

Pretendimi i pestë : GOE ka ofruar nje Çertifikate per siguri dhe shendet ne pune ,me noterim per inxhinierin Ilir Meliqi pas kerkeses se AK me sqarimet e kerkuara , por Noterimi I ofruar per kete çertifikat nuk perputhet me çertifikaten per siguri dhe shendet ne pune te ing. Ilir Meliqi pasiqe ne kete noterim nuk eshte cekur askund qe eshte noteruar kjo çertifikate (nuk ka permbajtje te dokumentit perkatesisht çertifikates) psh. Ne Noterim zakonisht ceket Nr. i certifikates me te cilin identifikohet certifikata .

Dhe si përfundim të nxjerr:

VENDIM

Me të cilin vendim të aprovoj Ankesën të bazuar të paraqitur nga .**OE : "VALDRINI" SH.P.K**

- ✓ Te kthej rastin ne rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me LPP dhe Rregullat prokurimit publik në Kosovë,
- ✓ Të anuloj njoftimin B58
- ✓ Të anuloj vendimin

Të shpërblej me kontratë **OE: "VALDRINI" SH.P.K** sepse është i përgjegjshëm sipas kritereve të përzgjedhjes dhe të vlerësimit dhe ka ofruar çmim me te lirë ne mesin e tenderëve të përgjegjshëm. Mbetemi me shpresë se Ankesa do të shqyrtohet pozitivisht.

Me respekt, Qëndrim Kurrumeli

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime administrative. Shpenzimet e ankesës 500.00 €, Fitimi i humbur.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

BASHKANGJITUR GJENI DESHMITË TONA TE NEVOJSHME LIDHUR ME KËTË AKTIVITET TE PROKURIMIT

HSK L.L.C.
Health and Safety at Work
Adresa: Ulpiana C7/H1. 10000 Prishtinë
Kontakti: +386 (0) 49 548 271
+377 (0) 44 168 026 ; +381(0) 38 548 271
e-Mail: info@hsk-ks.com ; www.hsk-ks.com

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË RISKUT NË VENDIN E PUNËS

Kompania e Licencuar për Siguri dhe Shëndet në Punë, **HSK, llc**, Prishtinë, me nr. Licencë 01/2017, me ekspertët e vet nga lëmia e SSHP-së ka bërë Vlerësimin e Riskut për sigurinë dhe shëndetin në punë, në **CONSTRUMAX sh.p.k – Suharekë, Republika e Kosovës.** Për realizimin e aktit të vlerësimit të Riskut në kompaninë **CONSTRUMAX sh.p.k, HSK llc,** ka përdor metodat për vlerësimin e Riskut sipas standardeve ndërkombëtare.

OHSAS 18001 dhe ISO 45001 për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Përfitimet nga këto standarde:

- **Krijimin e kushteve më të mira të punës në gjithë organizatën tuaj.**
- **Identifikimin e rreziqeve, dhe vendosjen e kontrollit në menaxhimin e tyre.**
- **Reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kosto dhe kohën joproduktive.**
- **Motivimin e stafit /punëtorëve me krijimin e kushteve më të mira dhe më të sigurta në punë.**
- **Dëshmimin e përputhshmërisë ndaj klientëve dhe furnitorëve.**

Metodologjia e punës:

- Marrja e të dhënave të përgjithshme për punëdhënësin (informacione të marra nga marrësi i shërbimeve);
- Marrja e të dhënave të përgjithshme për vendet e punës për të cilat është bërë vlerësimi i Riskut;
- Përshkrimi i procesit të punës, procesit teknologjike, mjetet për punë si dhe mjetet e pajisjet për mbrojtje personale gjatë punës;
- Përshkrimi i organizimit të punës;
- Vlerësimi i nivelit të Riskut në lidhje me rreziqet dhe dëmet;
- Klasifikimi dhe përshkrimi i Riskut në vendin e punës.

Hulumtimet janë bërë në të gjitha hapësirat e punës ku punëtorët kryejnë detyrat e tyre (hapësirat e prezentuara nga marrësi i shërbimeve)

Në këto hapësira janë bërë:

- Matjet mikroklimatike (temperatura e ajrit, rrymimi i ajrit, lagështia relative e ajrit, niveli i zhurmës dhe niveli i ndriçimit).
- Matjet dhe shqyrtimet e tokëzimit mbrojtës-prizat.
- Matjet dhe shqyrtimet e mbrojtjes reziduale –Fid.
- Matjet dhe shqyrtimet e tokëzimit mbrojtës të pajisjeve.

Gjatë kohës së përgatitjes së Aktit të Vlerësimit të Riskut, është bërë edhe trajnimi i:

- **25 punëtorëve, nga moduli për aftësimin e punëtorëve për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt, nga Lëmia e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.**
  (Të gjithë të trajnuarit janë pajisur me certifikata).

Dokumenti i vlerësimit të Riskut në Vendin e Punës është bërë për 10 (dhjetë) pozita pune.

Gjatë inspektimeve dhe matjeve të ndryshme në hapësirat e vendeve të punës, në përgjithësi është gjetur një gjendje e nivelit të lejuar dhe sipas standardeve për kryerjen e punimeve.

Është konstatuar se kujdesi më i shtuar ku duhet të bëhet është në pjesët ku punëtorët drejtpërsëdrejti janë në kontakt me pajisjet e punës, pasi që në ato vende pune, niveli i Riskut është në një shkallë më të lartë.

VENDET E PUNËS NË TË CILAT ËSHTË BËRË VLERËSIMI I RISKUT

Sipas vizitës dhe vëzhgimit në CONSTRUMAX sh.p.k, me njoftimin dhe vërtetimin e rreziqeve dhe dëmtuesve në vendet e punës, Vlerësimi i Riskut në raport me rrezikun dhe dëmtuesit, në vendet e punës, dhe në bazë të vlerësimit të mënyrës së marrjes së masave për parandalimin, largimin dhe zvogëlimin nivelit të riskut, vijmë në përfundim:

Vendet e punës në të cilat është bërë Vlerësimi i Riskut, në bazë të nenit 16, pika 1, Ligji nr. 04/L-161) – Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në punë:

Nr.	Vendet e punës	Niveli i Riskut
1.	DREJTOR	I MESËM 3.71
2.	PUNËTOR FIZIK	I MESËM 5.57
3.	ARMIRUES	I MESËM 5.71
4.	LATUES	I MESËM 5.71
5.	MURATOR	I MESËM 5.71
6.	VOZITËS	I MESËM (në të lartë) 6.71
7.	SUVATUES	I MESËM 7.43
8.	ROJTAR	I MESËM 4.86

REKOMANDOHET:

Punëdhënësi, duhet të obligoj personat e Autorizuar nga punëdhënësi për SSHP, që në kontinuitet të kujdesen për Sigurinë dhe Shëndetit në Punë të të gjithë punëtorëve.

Të respektojnë masat e parapara, e të paraqitura në aktin e Vlerësimit të Riskut, në mënyrë që të bëjnë parandalimin, largimin dhe zvogëlimin e shkallës së Riskut në të gjitha vendet e punës.

- Nëse ndërmirren masat e parapara për zvogëlim të riskut në këto vende të pune, e të paraqitura në këtë Akt të vlerësimit të riskut, vlerësohet se këto vende pune mund të mbetën me risk të konstatuar, dhe jo në rritje të shkallës së tij.
- Punëdhënësi obligohet që të gjitha sugjerimet dhe masat e parapara në këtë akt të vlerësimit të riskut, në mënyrë kontinuele të kujdeset t'i implementoj, të cilat masa ndikojnë drejtpërdrejt në mbarëvajtjen e kryerjes se punëve në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme, në të gjitha vendet e punës dhe te të gjithë punëtorët.
- Të sigurojë se instalimet dhe pajisjet për punë si dhe Mjetet Mbrojtëse Personale në punë të shfrytëzohen në bazë të standardeve dhe rregulloreve për Siguri në Punë, në bazë të normativave teknike dhe në mënyrë të rregullt të kontrollohet gjendja e tyre si dhe të mbahet evidenca e përhershme.
- Pajisjet dhe instalimet duhet rregullisht të mirëmbahen dhe për atë duhet të angazhohet organizatë e autorizuar dhe personat profesional, të cilët do të bëjnë testimin dhe inspektimin e tyre në mënyrë periodike dhe për të njëjtat kontrolla të lëshojnë certifikatë apo dokument tjetër përkatës për punën e rregullt të pajisjeve.
- Të sigurojë mbajtjen e trajnimeve të gjithë të punësuarve nga lëmia e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, nga mbrojtja prej zjarrit, dhe dhënies se ndihmës së parë.
- Të sigurojë që në vendet e punës nuk guxon të përdoret alkooli, si dhe substanca narkotike, si dhe të punësuarit të cilët gjenden nën ndikimin e alkoolit apo substancave tjera narkotike, të i largojë nga vendi i punës, për personat të cilët përdorin duhanin të sigurohet një hapësirë e veçantë për pirje të duhanit.
- Të ia ndaloj kryerjen e punës të gjithë të punësuarve të cilët nuk i zbatojnë rregullat e duhura për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe udhëzimet për kryerjen e punës në mënyrë të sigurt.
- Të sigurojë rregulloren për shfrytëzimin dhe përdorimin e pajisjeve dhe Mjeteve Mbrojtëse Personale për kryerjen e punëve.
- Të sigurojë Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, punëtorëve në vendet e punës, njerëzve që në çfarëdo mënyrë gjendet në punë, nxënësit dhe studentet gjatë mësimeve praktike dhe gjatë praktikës profesionale.
- Kontrolla sistematike shëndetësore, të bëhen te të gjithë te punësuarit, minimumi një herë në tri vite.
- Të sigurohen dhe të vendosen shenjat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, në të gjitha hapësirat e punës, si dhe shenjat për evakuim në të gjitha hapësirat e punës.
- Të vendoset këndi me pajisje të ndihmës së parë, sipas standardeve.

- Në rast të inspektimit nga Inspektorati i Punës, gjetjes së parregullsive, nga lëmia e Sigurisë dhe Shëndetit në punë, punëdhënësi obligohet qe ne afatin e parapare, te njëjtat t'i eliminojë dhe t'i evidentoj në listën për evidentime.
- Personi i Autorizuar nga punëdhënësi, duhet t'i mbanë në mënyrë të rregullt formularët nga Rregullorja nr. 03/2014 (MPMS):

- Formulari nr. 1 – Evidenca e vendeve – pozitave të punës me risk të rritur;
- Formulari nr. 2 – Evidenca e punonjësve, që punojnë në vendet e punës me risk të rritur;
- Formulari nr. 3 - Evidenca e lëndimeve në punë dhe sëmundjet lidhur me punën;
- Formuari nr. 4 – Evidenca për sëmundjet profesionale;
- Formulari nr. 5 – Evidenca e mbajtjes së trajnimeve për punë të sigurt;
- Formulari nr. 6 – Evidenca e materialeve të rrezikshme të cilat shfrytëzohen gjatë punës;
- Formulari nr. 7 – Evidenca për testimin e ambientit të punës;
- Formulari nr. 8 – Evidenca për kryerjen e kontrollit dhe testimit të pajisjeve të punës dhe pajisjeve për mbrojtje në punë;
- Formulari nr. 9 – Evidenca raporteve për SSHP për punonjësit, raporteve të inspektoreve të punës;
- Formulari nr. 10 – Evidenca e pajisjeve paraprake dhe periodike mjekësore;
- Për çdo punëtor të punësuar për herë të parë, të bëhet trajnimi i tij nga lëmia e SSHP, dhe paraprakisht të njoftohet me Vlerësimin Riskut për atë vend pune, ti bëhet kontrollimi sistematik shëndetësor.
- Për çdo hapësirë të re pune, të bëhen matjet e kushteve mikroklimatike dhe matjet e tokëzimit mbrojtës te të gjitha pajisjet të punës.
- Matjet mikroklimatike të bëhen dy herë në vit, matjet verore dhe dimërore.

AFATI: Në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e afateve

Datë, 15.06.2019 Prishtinë

Vlerësimin e bëri:

HSK llc

SIGURIA DHE SHENDETI NË PUNË
PRISHTINË
HEALTH AND SAFETY AT WORK

Pranoi:

CONSTRUMAX SH.P.K

S.H.P.K.

4	Furnizimi me material dhe vendosja e gureve skajor të mëdhenj , prej betoni me dimensione 18x24x100 cm, sipas standardit EN 1340, në pozicion të përfshihet të gjitha testimet si dhe punët e betonit për fiksimin e skajorëve në pozicionin e caktuar dhe mbushja e hapësirave mes tyre me beton.	m	300	€	11.00	€	3,300.00
5	Furnizimi i materjalit dhe vendosja e **kubzave të betonit me trashësi 8 cm** të atestuara dhe certifikuara me testin e ngrirje-shkrirjes, kriprave, abrazion, sipas EN standardeve ndërtimore.Ne cmim te perfshihet ngjeshja dhe nivelizimi I kubezave.	m²	500	€	16.00	€	8,000.00
6	Furnizimi I materjalit dhe vendosja e **rërës së imtë** mbi pllakat e vendosura, për mbushjen e fugave të tyre.	m³	6	€	6.00	€	36.00
7	Punimi i shtresës së asfalt-betonit AB16,furnizimi,transporti,shtruarja dhe ngjeshja me trashësi prej t=7cm. Në llogari të përfshihet edhe marrja e mostrave të asfaltit dhe shqyrtimi I tyre ne laborator të licencuar, rezultatet ti dorezohen Menaxherit të Projektit.	m²	2000	€	11.00	€	22,000.00
8	Punimi i shtresës së asfalt-betonit AB11,furnizimi,transporti,shtruarja dhe ngjeshja me trashësi prej t=5cm. Në llogari të përfshihet edhe marrja e mostrave të asfaltit dhe shqyrtimi I tyre ne laborator të licencuar, rezultatet ti dorezohen Menaxherit të Projektit.	m²	2000	€	7.00	€	14,000.00
9	Shenjëzimi I vendparkingjeve vendkalimit për këmbësor (zebrave),me ngjyrë plastike 2K (dy komponentëshe) me grimca fluroscente.	m²	120	€	3.00	€	360.00
					Gjithësejt :	**€**	**63,726.00**
IV.	**PUNËT E DRENAZHËS**						
1	Gërmimi I dheut të kategorisë III dhe IV, si dhe largimi deri ne deponi, sipas projektit të kanalizimit atmosferik për largimin e ujit nga siperfaqja e parkingut.	m³	90	€	2.50	€	225.00
2	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit nga guri I lumit i granuluar ne fraksion 3 / 4 mm - mbi gypin e kanalizimit.	m³	90	€	5.50	€	495.00
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave të brinjëzuar HDPE SN4 Ø160 mm për largimin e ujit nga siperfaqja e parkingut (Të mbyllur dhe me vrima). Gjatë punës të kontrollohet ramja, në qmim të përfshihen të gjitha pjesët fazonike për funksionalizimin e kanalizimit atmosferik.	m	200	€	3.50	€	700.00
4	Furnizimi, transporti dhe montimi I pusetave metalike ujëmbledhëse në form katrore me grila, me aftësi mbajtëse 40 ton, në çmim të përfshihet betoni C25/30, për ndërtimin e kurorës së ujëmbledhësit.	copë	12	€	50.00	€	600.00

AAB Construction SH.P.K PRISHTINË

Në bazë të Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Neni 20, si dhe në përputhje Licencës Nr. 03/2018, për ushtrimin e punëve profesionale nga Siguria dhe Shëndeti në Punë, kompania NMA SH.P.K., lëshon këtë:

CERTIFIKATË

Ilir Meleqi

Për pjesëmarrje në trajnimin nga Siguria dhe Shëndeti në Punë

Punëdhënësi: BM GROUP SH.P.K.

Pozita e punës: Inxhinier i ndërtimtarisë

Nr. i certifikatës: 0074/2024

NMA SHPK

Data e trajnimit: 30.01.2024
Data e lëshimit: 31.01.2024
Data e skadimit: 29.01.2026

Kjo certifikatë lëshohet bazuar në trajnimin e realizuar dhe në përputhje me autorizimet e licencës nga MPMS, me Nr. 03/2018.

Adresa: NMA Sh.P.K., Rr. Ferid Curri, Arbëri – Prishtinë
www.nma-ks.com; info@nma-ks.com; +383 (0) 44 11 90 09

REPUBLIKA E KOSOVES
NOTER
FATMIR TASHOLLI
LIPJAN

LRP.nr.2237/2024----------

VËRTETIM I KOPJES NGA ORIGJINALI----------

Unë Fatmir Tasholli, Noter në Lipjan, Rr. "Gjergj Fishta" pa nr, me kërkesë të ***Skender Cakaj*** *i lindur me dt.21 maj 1961 në Stanoc i Epërm, identitetin e te cilit e konstatova në bazë të letërnjoftimit me numër personal : 1001146544 të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës vërtetoj se kopjet e bashkangjitura përputhen në çdo aspekt me origjinalin, pjesa integrale e të cilit origjinal ka gjithësej një fletë dhe një faqe në një anë dhe vërtetuar një herë.*----------

Fotokopjimi sipas Ligjit është bërë në Zyrën time, ndersa origjinali ndodhet tek pala.----------

Në mbështetje të nenit 47 par. 3.1 të Ligjit nr. 06/L-010 "Për Noterinë", të njejtin e vërtetoj. Tarifa noteriale në shumë prej 1.€+18% TVSH për faqe është paguar konformë të UA, Nr.05/2022, mbi Tarifën noteriale shtesë noteriale. ----------

Lipjan, datë 05.03.2024 (pesë mars të vitit dy mijë e njëzet e katër).----------

Noteri:
Fatmir Tasholli

Akti i Noterit i Republikës së Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY

UNIREF

PPQDD111111111H

PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS
PLAĆANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT

Të dhënat e OE Podaci EO EO data	Valdrini sh.p.k, FEHMI LLADROVCI BLLOKU 7 BANESA 4, 13000 GLLOGOC
Përshkrimi Opis Description	Rregullimi i hapësirës publike te QMF-ja dhe Kompleksi 300 në rrugët 28 Nëntori dhe Kuvendi i Lezhës në Fushë Kosovë
Numri i prokurimit Broj nabavke Procurement number	612-24-1030-5-2-1
Shuma / Iznos Ammount	€ 1130 Euro 00 Ct Data / Datum / Date
Me fjalë / Rečima In words	
Xhirollogaria Broj žiroračuna Bank account	1000430070005756
Lëshuar nga Izdato od / Issued by	OSHP

BANKA EKONOMIKE SH.A.
25 - 05 - 2024
Nëndega Dreni
Arka nr. 161
1061

Nënshkrimi dhe vula e bankës
Potpis i pečat banke
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife te ankesave ne OSHP. a. Kurdo qe ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim te një kontrate, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) te vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro. b. Kurdo qe aneksa nderlidhet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) te vlerës se parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.	14.2 U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN. a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €. b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.

Banka Ekonomike
www.bekonomike.com

Valuta	
EUR	
USD	
CHF	
GBP	

Apoena	Numër
1,000	
500	
200	
100	
50	
20	
10	
5	
2	
1	
0.5	
0.2	
0.1	
0.05	
0.02	
0.01	

Numri unik: ZAAF240325121218
Numri i Llogarisë: 9253

Emri i Llogarisë: ORGANI SHQYRTUES i PROKURIMIT

Emri i Paguesit: VALDRINI SHPK
Qëllimi i Pagesës: pagese per depozite per sigurim te ankeses 612-24-1030-5-2-1;
Emri dhe mbiemri: VALDRINI SHPK
Kompania: OSHP
Përshkrimi: PAGESE PER DEPOZITE PER SIGURIM TE ANKESES 612-24-1030-5-2-1
UNIREF: PPQDD1111111111H

Nga llogaria: 1401000000628545 - VALDRINI SH.P.K.

Valuta: EUR Provizion:1.50 Total Shuma: 1131.5

Shuma me fjalë: Një mijë e një qind e tridhjetë e një e Pesëdhjetë cent

Data Pagesës: 25.03.2024 Arkatari: Samile Shala Nënshkrimi i Klientit: _____.

BANKA EKONOMIKE SH.A.
25 -03- 2024
Nëndega Drenas
Arka nr. 161
1061

Unë / Ne deklaroj/më se ky transakcion ka prejardhje nga biznesi legal dhe nuk përdoret për të fshehur ose mbuluar ndonjë prejardhje jolegale.
We hereby declare that this transaction is obtained from a legal business/origin and is not indented to hide or cover any illegal origin.

09

20.03.2024

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË
OPSTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË – KOSOVË , KOSOVO POLJE

Ne mbeshtetje te nenit 108/A te ligjit nr.04/L-042 per Prokurim Publik te Republikes se Kosoves, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092, si dhe duke pasur parasysh ankesen dorezuar ne Komune nga OE **"Valdrini" shpk** per aktivitetin e prokurimit tenderin "Rregullimi i hapsires publike te QMF-SE dhe kompleksi 300 ne rruget 28 nentori dhe Kuvendi i Lezhes ne Fushe Kosove" me nr te mbrendshem te prokurimit prokurimit 612 24 001 521, Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit nxerr kete vendim.

VENDIM

Vleresohet kerkesa per rishqyrtim e OE "Valdrini" shpk si e pa bazuar per aktivitetin e prokurimit : "Rregullimi i hapësirës publike tek QKMF-ja dhe Kompleksi 300 në rrugët 28 Nentori dhe Kuvendi i Lezhes ne Fushe Kosove " me nr te prokurimit 612 24 001 521.

RAPORTI I ZYRTARIT PERGJEGJES TE PROKURIMIT

	16.03.2024	19.03.2024	20.03.2024
Nenshkrimi i Zyrtarit Pergjegjes te Prokurimit	Data e pranimit te kerkeses per rishqyrtim	Data e fillimit te rishqyrtimit te kerkeses	Data e dorezimit te vendimit **"Valdrini" sh.p.k**

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrveshjeve

Me daten 16.03.2024 Autoriteti Kontraktues ka pranuar kerkesen per rishqyrtim nga OE , **"Valdrini" shpk** si pale e interesuar per aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i hapsires publike te QMF-SE dhe kompleksi 300 ne rruget 28 nentori dhe Kuvendi i Lezhes ne Fushe Kosove **"** me nr te prokurimit 612 24 001 521 te inicuar nga (AK-Komuna e Fushe Kosoves)-Zyra e Prokurimit.

Konform nenit 108/a pika 6 te LPP dhe konforme kerkeses te dates 16.03.2024. Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit ka shqyrtuar dhe analizuar lenden e OE **"Valdrini" shpk .**

"Valdrini" shpk

Dispozitat e shkelura nga AK

Të pa kënaqur me Vendimin e AK- Autoriteti kontraktues – **KOMUNA FUSHE KOSOVE** dhe n pajtim me nenin 108A të LPP-së parashtrojmë kërkese për rishqyrtim kundër;

- **Njoftimit për eliminimin (Letrën standarde për tenderues te pasuksesshem) nga aktivitet i mëtejmë i prokurimit.**
- **Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës : 11.03.2024**

Për shkak të shkelje të dispozitave të;

- Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (n tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

- Nenin 1, Qëllimi, par 1 dhe 3.
- Nenin 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1.
- Nenin 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6
- Neni 10, Qasja në dokumentacion
- Nenin 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien Kontratave, par 1, nen par 1.1 ; 1.2 dhe par 3.
- Nenin 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 2 dhe 4
- Nenin 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1
- Nenin 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, par 1.
- Nenin 72 të LPP-së, të Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, par 1 dhe 2.

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Nenin 38, Sqarimi i Tenderëve, par 38.1
- Nenin 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a; b dhe c
- Nenin 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen (d) dhe (o)

III. Dispozitat e Udhëzuesit nr. 01/2023 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi UA2) dhe atë:

- 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së.

"Valdrini" shpk

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

- <u>Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore: Sa i përket Formulari Letrës standarde për tenderues te ELIMINUAR.</u>

E kundërshtojmë në tërësi vendimin e AK lidhur me letrën standarde për tenderues te pasuksesshem, për faktin se arsyetimi i AK sa i përket eliminimit të ofertës tonë është i pa bazuar dhe në shkelje të kërkesave te përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT dhe në shkelje të dispozitave Ligjore të LPP-së.

Pretendimi i parë : Ne dosjen e tenderit te pika 9.1 & 9.2 te kapaciteti teknik dhe profesional pika 5. OE duhet te ofroj vleresimin e riskut nga nje kompani e licencuar nga MPMS , sipas Ligjit Nr.04L 161 per siguri dhe shendet ne pune dhe certifikatat per siguri dhe shendet ne pune per stafin profesional dhe punetoret.
Dëshmia e kerkuar dokumentare : 5. Deshmi -kopja e certifikates per siguri dhe shendet ne pune e noterizuar nga origjinali per stafin profesional dhe per punetoret e angazhuar ne kete projekt. Po ashtu kopja e licences se OE-se e cila e ka kryer vleresimin e riskut se bashku me raportin e vleresimit nga kompania e licencuar nga MPMS-ja.
-Pretendimi i parë: Ne bazë te dokumenteve te ofruara ne ofertën e dhënë GOE : **AAB Construction SH.P.K & Construmax shpk** , perkatesisht antari i grupit CONSTRUMAX SH.P.K ka ofruar vlersimin e rriskut te cilin e ka kryer te kompania **HSK L.L.C - Prishtinë** . Ky vlersim I rriskut është bërë me datën :**15.06.2019** ,ketij vlersimi të rriskut I ka kaluar afati (nuk ka validitet) sepse ne bazë të rregullores **02/2021** per vlersimin e rriskut neni 15 i rregullores pika 1: Tregon qartë qe vlersimi i rriskut duhet te rishikohet ne çdo dy vite , qka nenkupton qe vlersimi i rriskut i ofruar nga kompania Construmax shpk nga data **15.06.2021** nuk ka validitet, pra ketij dokumenti i ka kaluar validiteti.
Po ashtu Licensa e kompanise e cila e ka kryer vlersimin e rriskut HSK L.L.C eshte leshuar me

datë : 29.11.2017 , sipas rregullores duhet te vazhdohet qdo dy vjet , qka nenkupton qe kjo license nuk ka afat , pra i ka kaluar validiteti.

Pretendimi i dytë : Ne bazë te paramases dhe parallogarise te ofruara ne ofertën e dhënë **GOE : AAB Construction SH.P.K & Construmax shpk** , te pjesa III e paramases (Mbushja,rregullimi i hapesires dhe punet e asfaltit) ,perkatesisht pikat 7 dhe 8 , GOE ka ofruar dy qmime te ndryshme te asfaltit për trashesi ne 1 cm ,

Te pika 7. Punimi I shtreses se asfalt-betonit AB16 , trashesia t= 7cm ka ofruar qmimin 11 € qe i bie 1.57 €/cm

Ndersa te pika 8. Punimi I shtreses se asfalt-betonit AB11 , trashesia t= 5cm ka ofruar qmimin 7 € qe i bie 1.40 €/cm , ketu kemi nje kontra ndryshim te qmimeve per 0.17 € (12%) , pasi qe qmimet e asfaltit ne treg janë : per Lloje te asfaltit me fraksione me te medha janë më të lira ndersa per Lloje te asfaltit me fraksione me te vogla jane me te shtrenjeta pasi qe sasia e bitumenit eshte me e madhe per fraksione me te vogla dhe qmimi i zhavorit me te vogel eshte me i madh.

Pretendimi i tretë : GOE ka ofruar nje Çertifikate per siguri dhe shendet ne pune ,me noterim per inxhinierin Ilir Meliqi pas kerkeses se AK me sqarimet e kerkuara , por Noterimi I ofruar per kete çertifikat nuk perputhet me çertifikaten per siguri dhe shendet ne pune te ing. Ilir Meliqi pasiqe ne kete noterim nuk eshte cekur askund qe eshte noteruar kjo çertifikate (nuk ka permbajtje te dokumentit perkatesisht çertifikates) psh. Ne Noterim zakonisht ceket Nr. i certifikates me te cilin identifikohet certifikata .

Dhe si përfundim të nxjerrë:

VENDIM

Me të cilin të vendim të aprovoj kërkesën për rishqyrtim të bazuar të paraqitur nga .**OE : "VALDRINI" SH.P.K**

- ✓ Te kthej rastin ne rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me LPP dhe Rregullat prokurimit publik në Kosovë,
- ✓ Të anuloj njoftimin mbi vendimin e AK-së - B58

Të shpërblej me kontratë **OE: "VALDRINI" SH.P.K** sepse është i përgjegjshëm sipas kritereve të përzgjedhjes dhe të vlerësimit dhe ka ofruar çmim me te lirë ne mesin e tenderëve të përgjegjshëm. Mbetemi me shpresë se Kërkesa për Ri-shqyrtim do të shqyrtohet pozitivisht.

Me respekt, Qëndrim Kurrumeli

"Valdrini" shpk

Dëmet materiale

Shpenzime administrative, Shpenzimet e ankesës 500.00 €, Fitimi i humbur.

Procesi i prokurimit

Data e njoftimit per kontrate.....13.02.2024
Lloji i procedures se aplikuar.....e hapur
Afati i fundit per dorezimin e ofertave.....05.03.2024
Data e hapjes se ofertave.....05.03.2024
Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.....11.03.2024

Kriteret per vleresim

		Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
		1.Përstatshmëra e OE me kërkesat e nenit 65 të Ligjit Nr.04 L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.	**1.Deklarata nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e Aneksi 7 dosjen e tenderit.**
		2. Vertetimi nga ATK-ja .	**2.Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nu jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së pa deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimi tenderit (duhet të dorëzohet nga tenderuesi propozohet për dhënje të kontratës -kopje)**
		3. Vertetimi nga Gjykata.	**3.Një vërtetim nga autoriteti kompetent gjyqësor i vendit te themelusit të tenderuesi (GjTHK) se tenderuesi nuk ka pengesa lidhur Kërkesat e pershtatshmerise Pika 6.2 .nën a,c,d,e,f dhe pika 6.3 nen a.b. dhe d. të dosj se tenderit jo me te vjeter se 6 (gjashtë) mua nga data e fundit te dorezimit te tenderit (du të dorëzohet nga tenderuesi që propozohet p dhënje të kontratës- origjinali ose kopje e noterizuar)**

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale: **1.Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përk publik në vendin e juaj të themelimit me të c evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomi atë vend – kopja e numrit unik identifikues o çertifikatës së biznesit.**
		2.Çertifikata e regjistrimit për TVSH	**2. Kopja e çertifikates se regjistrimit për TVS (deklarues)**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional: **1. OE duhet të dëshmojë se ka përfunduar me sukses punë të natyrës së ngjashme në periudhën e shkuar 3 vjeçare nga data e publikimt të këtij njoftimi për kontratë, vlera e kontratave duhet të jetë jo më pak se 172,500.00 euro. Ne rast të grupit lideri duhet ti ketë së paku 60 % të shumës së kërkuar.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1. Një listë të kontratave të realizuar në tri e fundit të nënshkruar dhe vulosur nga OE saktësuar datën, titullin e projektit, numrir prokurimit dhe vlerën e projektit (origjinal Projektet duhet të jenë të dëshmuara me kontrata dhe referenca (kopje).**
		2. Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt min. -10 puntor . Në rast te grupit lideri duhet ti kete min.6 punetor. Ne kuader te stafit OE duhet te kete nje inxhinjer te diplomuar i elektroteknikes , sistemi 5 vjeqar ose master.	**2. Lista e stafit profesional e nënshkruar dh vulosur nga OE, duke specifikuar Emrin, Mbiemrin, Pozitën në kompani të dëshmua kontratë të punës dhe te jetë ne listën e të punesuarve.Per inxhinjerin e elektroteknik kerkohet te kete me së paku tri vite përvoj pune në profesion e dëshmuar me CV, dipl mbi kualifikimin, vërtetimin mbi përvojën punës ,leter reference nga punedhensi ose çfardo dokumenti tjeter qe deshmohet per punet dhe pervojen e meparshme inxhinje ne lemin e caktuar, të jetë në listën e të punësuarve ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi .**

		3. OE duhet të emëroj menaxherin e projektit, i cili duhet të jetë Inxhinier I diplomuar i ndertimtarise - konstruktiv . Në rast të grupit Menaxheri duhet të jetë pjesë e stafit të Liderit.	3.OE në kuadër të stafit duhet të emëroj m vendim ose deklarate menaxherin e projek cili duhet të jet inxhinjer i ndertimtarise - konstruktiv ,me së paku tri vite përvojë pu profesion e dëshmuar me CV, diplomën mb kualifikimin, vërtetimin mbi përvojën e pur ,leter reference nga punedhensi ose çfardo dokumenti tjeter qe deshmohet per punet pervojen e meparshme inxhinjerike ne lem caktuar, të jet në listën e të punësuarve os ketë marrëveshje bashkëpunimi .
		4. OE duhet të posedoje paisje teknike të nevojshme(min.2 kamiona min 10 ton, min.1 grejder,min. nje cilinder 18 ton, min. nje ngarkues max.10 ton, min. nje eskavator , min.nje finisher.	4. Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknik janë në dispozicionin tuaj për te ekzekutua kontraten në fjalë- pajisjet dhe makineria r dispozicion duhet të dëshmohen me kopje librezave mbi pronësinë e tyre (të noterizu ose DUD-i doganor. Në rast të marrjes me duhet të dëshmohet edhe me kontratë e noterizuar mbi qeramarrjen.
		5. OE duhet te ofroj vleresimin e riskut nga nje kompani e licencuar nga MPMS , sipas Ligjit Nr.04L 161 per siguri dhe shendet ne pune dhe certifikatat per siguri dhe shendet ne pune per stafin profesional dhe punetoret.	5. Deshmi -kopja e certifikates per siguri dh shendet ne pune e noterizuar nga origjinali stafin profesional dhe per punetoret e ang ne kete projekt. Po ashtu kopja e licences s se e cila e ka kryer vleresimin e riskut se ba me raportin e vleresimit nga kompania e licencuar nga MPMS-ja.
		6. OE duhet te ofroj Certifikaten ISO 9001 2015	6.ISO 9001 2015 mbi sistemin e menaxhim cilesis - kopje me validitet
Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	a. **një deklaratë e qartë** ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b. **një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët**, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. **një deklaratë të nënshkruar** nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.	

Nënkontraktimet	12.1	a. **një deklaratë** ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatëse të prokurimit, dhe b. Të gjithë kontraktorët do **të jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.
Siguria e tenderit	13.1	A është e nevojshme siguria e tenderit: Po ☒ Jo ☐ Tenderuesi duhet të depozitoj sigurimin e tenderit.
	13.2	Vlera e sigurisë së tenderit **2500** Vlefshmëria e sigurisë së tenderit ne ditë **90** apo muaj
Siguria e ekzekutimit	14.1	Siguria e kërkuar e ekzekutimit: Po ☒ Jo ☐ Në rast të dhënies së kontratës juve, ju duhet të postoni, para nënshkrimit të kontratës, sigurinë e ekzekutimit.
	14.2	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është **10% e vleres se kontrates ne kohezgjatje prej 30 ditesh pas impelentimit te kontrates** .
Sqarimi i Dosjes së Tenderit	16.1	**24.02.2024**
Dokumentet qe përbejnë Tenderin	19.1(h)	
Periudha vlefshmërisë së tenderit	21.1	Periudha e vlefshmërisë se tenderit do të jetë: **60** ditë.
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	23.1	Afati i fundit për dorëzim është je **05.03.2024 13:30:00** Vendi: **Platforma e-prokurim**
Hapja e Tenderit	26.1	Hapja e tenderit do te bëhet me **05.03.2024 13:30:00** Vendi: **Zyra e Prokurimit,kati i I, nr.21**
Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët]; ☒
Ankesat	31.3	*Rruga 'Tahir Zemaj nr.2*

Rexhistri i ofertueseve sipas procesverbalit te hapjes publike

Nr.	Emri i Operatorit Ekonomik	Vlera totale e Ofertes
1.	GOE "Bini" shpk &"Bereqeti-ing"	129 996.80 €
2.	Grupi i OE "AAB Construction" sh.p.k, "Construmax" sh.p.k	109 461.90 €
3.	OE "Valdrini" sh.p.k	113 000.00 €
4.	OE "Eurotrans" sh.p.k,	140 493.50 €

Procesverbali i hapjes eshte nenshkruar nga anetaret e komisionit te hapjes te AK si dhe nga Zyrtari i Prokurimit.

Perberja e komisionit rivleresues :

- Mobere Pllana
- Fatmire Miftari
- Gezim Shabani

Data e mbarimit te vleresimit 11.03.2024
Data e nenshkrimit te raportit te vleresimit nga Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit.....11.03.2024

Raporti i komisionit vleresues

Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit, krahasimit dhe vleresimit te ofertave i rekomandon ZPP-se, qe projektin "Rregullimi i hapësirave publike te QMF-fa dhe kompleksi 300 ne rrugët 28 nentori dhe Kuvendi i Lezhes ne Fushe Kosove" ta kryej GOE "AAB Construction" shpk dhe "Construmax" shpk pasiqe ka ofruar çmimin me te ulet dhe eshte i përgjegjshëm me me dokumentacionin e kerkuar ne FDT dhe dosjen e tenderit.

Analizat dhe sqarimet e Zyrtarit Pergjegjes te Prokurimit per OE "Valdrini" shpk

Sqarim ne pretendimin ankimor 1 GOE " AAB Construction" shpk & "Construmax" shpk, perkatesisht anetari i grupit "Construmax" shpk kane ofruar vleresimin e riskut te cilin e ka kryer kompania HSK L.L.C Prishtine. Ky vleresim i riskut eshte bere me daten 15.06.2019. Ne si AK permes letres standarde per sqarim te tenderit kemi kerkuar sqarime shtese nga GOE " AAB Construction" shpk & "Construmax" shpk, ku nga i njëjti kemi pranuar Raportin përfundimtar te rishikimit te vlerësimit te riskut ne vendin e punës të datës 01.06.2023 i cili është valid ashtu siç është parpare ne nenin 15, pika 1 te rregullores (MPMS) Nr. 02/2021 per Vleresimin e Riskut ne Vendin e Punes. Andaj vleresojme se GOE " AAB Construction" shpk & "Construmax" shpk ka plotesuar deshmite ashtu sic eshte kerkuar ne dosjen e tenderit pika 9.1 dhe 9.2 te kapacitetit teknik dhe profesional pika 5.

HSK L.L.C.
Health and Safety at Work
Adresa: Ulpiana C7/III, 10000 Prishtinë
Kontakt: +383 (0) 49 548 271
+383 (0) 44 168 026 ; +383(0) 49 548 271
e-Mail: info@hsk-ks.com ; www.hsk-ks.com

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I RISHIKIMIT TË VLERËSIMIT TË RISKUT NË VENI PUNËS

Kompania e Licencuar për Siguri dhe Shëndet në Punë, **HSK, llc**, Prishtinë, me nr. Licencë 01/2017, me eks vet nga Iëmia e SSHP-së ka bërë Rishikimin e Vlerësimit të Riskut për sigurinë dhe shëndetin në p **CONSTRUMAX sh.p.k** Bazuar në Rregulloren 02/2021 [MPMS] për Vlerësimin e Riskut në vendet e pu realizimin e Rishikimit të Vlerësimit të Riskut në kompaninë, **CONSTRUMAX sh.p.k., HSK llc**, ka përdorur i për Rishikim të Vlerësimit të Riskut sipas standardeve ndërkombëtare.

OHSAS 18001 dhe ISO 45001 për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Përfitimet nga këto standarde:

- ***Krijimin e kushteve më të mira të punës në gjithë organizatën tuaj.***
- ***Identifikimin e rreziqeve, dhe vendosjen e kontrollit në menaxhimin e tyre.***
- ***Reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kos kohën joproduktive.***
- ***Motivimin e stafit/punëtorëve me krijimin e kushteve më të mira dhe më të sigurta në p***
- ***Dëshmimin e përputhshmërisë ndaj klientëve dhe furnitorëve.***

Metodologjia e punës:

- Marrja e të dhënave të përgjithshme për punëdhënësin (informacione të marra nga marrësi i shërbi
- Marrja e të dhënave të përgjithshme për vendet e punës për të cilat është bërë vlerësimi i Riskut;
- Përshkrimi i procesit të punës, procesit teknologjike, mjetet për punë si dhe mjetet e pajisjet për m personale gjatë punës;
- Përshkrimi i organizimit të punës;
- Vlerësimi i nivelit të Riskut në lidhje me rreziqet dhe dëmet;
- Klasifikimi dhe përshkrimi i Riskut në vendin e punës.

Hulumtimet janë bërë në të gjitha hapësirat e punës ku punëtorët kryejnë detyrat e tyre (*hapësirat prezentuara nga marrësi i shërbimeve*)

Në këto hapësira janë bërë:

- **Matjet mikroklimatike (*temperatura e ajrit, rrymimi i ajrit, lagështia relative e ajrit, niveli i zhurmës dhe niveli i ndriçimit*).**
- **Matjet dhe shqyrtimet e tokëzimit mbrojtës-prizat.**
- **Matjet dhe shqyrtimet e mbrojtjes reziduale –Fid.**
- **Matjet dhe shqyrtimet e tokëzimit mbrojtës të pajisjeve.**
- **Matja dhe shqyrtimi i tokëzimit mbrojtës të Rrufepritësit.**

Gjatë kohës së përgatitjes së Aktit të Rishikimit të Vlerësimit të Riskut, është bërë edhe trajnimi i:

- 13 punëtorëve, nga moduli për aftësimin e punëtorëve për kryerjen e punëve në mënyrë t sigurt, nga lëmia e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Dokumenti i Rishikimit të Vlerësimit të Riskut në Vendin e Punës është bërë për 8 (tetë) poz pune.

Gjatë inspektimeve dhe matjeve të ndryshme në hapësirat e vendeve të punës, në përgjithësi është gjetu gjendje e nivelit të lejuar dhe sipas standardeve për kryerjen e punimeve.

Është konstatuar se kujdesi më i shtuar ku duhet të bëhet është në pjesët ku punëtorët drejtpërsëd janë në kontakt me pajisjet e punës, pasi që në ato vende pune, niveli i Riskut është në një shkallë më lartë.

VENDET E PUNËS NË TË CILAT ËSHTË BËRË RISHIKIMI I VLERËSIMI I RISKUT

Sipas vizitës dhe vëzhgimit në kompainë **CONSTRUMAX sh.p.k.** me njoftimin dhe vërtetimin e rreziqeve dëmtuesve në vendet e punës, Rishikimi i Vlerësimit të Riskut në raport me rrezikun dhe dëmtuesit, në venc punës, dhe në bazë të vlerësimit të mënyrës së marrjes së masave për parandalimin, largimin dhe zvogëlimin ni të riskut, vijmë në përfundim:

Vendet e punës në të cilat është bërë Rishikimi Vlerësimi i Riskut, në bazë të Rregullores 02/2021 [MPMS] Vlerësimin e Riskut në vendet e punës.

Nr.	Vendet e punës
1.	DREJTOR
2.	PUNËTOR FIZIK
3.	ARMIRUES
4.	LATUES
5.	MURATOR
6.	VOZITËS
7.	SUVATUES
8.	ROJTAR

REKOMANDIMET:

Punëdhënësi, duhet të obligoj personat e Autorizuar nga punëdhënësi për SSHP, që në kontinu të kujdesen për Sigurinë dhe Shëndetit në Punë të të gjithë punëtorë Të respektojnë masat e parapara, e të paraqitura në aktin e Rishikimit të Vlerësimit të Riskut mënyrë që të bëjnë parandalimin, largimin dhe zvogëlimin e shkallës së Riskut në të gjitha ven e punës.

- Nëse ndërmirren masat e parapara për zvogëlim të riskut në këto vende të pune, e të paraqit në kët Akt të Rishikimit të Vlerësimit të Riskut, vlerësohet se këto vende pune mund të mbe me risk të konstatuar, dhe jo në rritje të shkallës së tij.
- Punëdhënësi obligohet që të gjitha sugjerimet dhe masat e parapara në këtë akt të vlerësimi riskut, në mënyrë kontinuele të kujdeset t'i Implementoj, të cilat masa ndikojnë drejtpërdrejt mbarëvajtjen e kryerjes se punëve në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme, në të gjitha ven e punës dhe te të gjithë punëtorët.
- Të sigurojë se instalimet dhe pajisjet për punë si dhe Pajisjet Personale Mbrojtëse në punë shfrytëzohen në bazë të standardeve dhe rregulloreve për Siguri në Punë, në bazë të normativa teknike dhe në mënyrë të rregullt të kontrollohet gjendja e tyre si dhe të mbahet evidenc përhershme.
- Pajisjet dhe instalimet duhet rregullisht të mirëmbahen dhe për atë duhet të angazhol organizatë e autorizuar dhe personat profesional, të cilët do të bëjnë testimin dhe inspektimi tyre në mënyrë periodike dhe për të njëjtat kontrolla të lëshojnë certifikatë apo dokument tje përkatës për punën e rregullt të pajisjeve.
- Të sigurojë mbajtjen e trajnimeve të gjithë të punësuarve nga lëmia e Sigurisë dhe Shëndetit Punë, nga mbrojtja prej zjarrit, dhe dhënies se ndihmës së parë.
- Të sigurojë që në vendet e punës nuk guxon të përdoret alkooli, si dhe substanca narkotike, si d të punësuarit të cilët gjenden nën ndikimin e alkoolit apo substancave tjera narkotike, të i largo nga vendi i punës, për personat të cilët përdorin duhanin të sigurohet një hapësirë e veçantë p pirje të duhanit.
- Të ia ndaloj kryerjen e punës të gjithë të punësuarve të cilët nuk i zbatojnë rregullat e duhura p Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe udhëzimet për kryerjen e punës në mënyrë të sigurt.
- Të sigurojë rregulloren për shfrytëzimin dhe përdorimin e pajisjeve dhe Pajisjet Persona Mbrojtëse për kryerjen e punëve.

Të sigurojë Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, punëtorëve në vendet e punës, njerëzve që në çfarëd mënyrë gjendet në punë, nxënësit dhe studentet gjatë mësimeve praktike dhe gjatë praktik profesionale.

- Kontrolla sistematike shëndetësore, të bëhen te të gjithë te punësuarit, minimumi një herë në t vite.
- Të sigurohen dhe të vendosen shenjat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, në të gjitha hapësirat punës, si dhe shenjat për evakuim në të gjitha hapësirat e punës.
- Të vendoset këndi me pajisje të ndihmës së parë, sipas standardeve.
- Pajisjet e punës duhet të kenë udhëzimin për përdorimin e tyre, në gjuhë të cilen e kuptojn punëtorët
- Në rast të inspektimit nga Inspektorati i Punës, gjetjes së parregullësive, nga lëmia e Sigurisë dh Shëndetit në punë, punëdhënësi obligohet qe ne afatin e parapare, te njëjtat t'i eliminojë dhe t' evidentoj në listën për evidentime.
- Personi i Autorizuar nga punëdhënësi, duhet t'i mbajë në mënyrë të rregullt nga:

- ***Formulari nr. 1 – Evidenca e vendeve – pozitave të punës me risk të rritur;***
- ***Formulari nr. 2 – Evidenca e punonjësve, që punojnë në vendet e punës me risk të rritur;***
- ***Formulari nr. 3 - Evidenca e lëndimeve në punë dhe sëmundjet lidhur me punën;***
- ***Formuari nr. 4 – Evidenca për sëmundjet profesionale;***
- ***Formulari nr. 5 – Evidenca e mbajtjes së trajnimeve për punë të sigurt;***
- ***Formulari nr. 6 – Evidenca e materialeve të rrezikshme të cilat shfrytëzohen gjatë punës;***
- ***Formulari nr. 7 – Evidenca për testimin e ambientit të punës;***
- ***Formulari nr. 8 – Evidenca për kryerjen e kontrollit dhe testimit të pajisjeve të punës dh pajisjeve për mbrojtje në punë;***
- ***Formulari nr. 9 – Evidenca raporteve për SSHP për punonjësit, raporteve të inspektoreve t punës;***
- ***Formulari nr. 10 – Evidenca e pajisjeve paraprake dhe periodike mjekësore;***
- Për çdo punëtor të punësuar për herë të parë, të bëhet trajnimi i tij nga lëmia e SSHP, dh paraprakisht të njoftohet me Vlerësimin Riskut për atë vend pune, ti bëhet kontrollimi sistematik shëndetësor.
- Për çdo hapësirë të re pune, të bëhen matjet e kushteve mikroklimatike dhe matjet e tokëzimit mbrojtës te të gjitha pajisjet të punës.
- Matjet mikroklimatike të bëhen dy herë në vit, matjet verore dhe dimërore.
- Bazuar në Rregulloren 02/2021 (MPMS), Rishikimi i Vlerësimit të Riskut bëhet çdo dy vite.

AFATI: Në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e afateve

Datë: 01-06-2023; Prishtinë

Vlerësimin e bëri:	**Pranoi:**
HSK llc	**CONSTRUMAX sh.p.k**
per	

Sqarim ne pretendimin ankimor 2

Pretendimi juaj ankimore se ne pjesen III te paramases (mbushja, rregullimi i hapesires dhe punet e asfaltit), perkatesisht pika 7 dhe 8, GO"E AAB Construction" shpk & "Construmax" shpk ka ofruar cmime te ndryshme te asfaltit (t =7 cm -cmimi i asfaltit 11 euro dhe t=5 cm-cmimi i asfaltit 7 euro).
Vendosja e cmimit eshte e drejt e GOE "AAB Construction" shpk & "Construmax" shpk dhe se askush nuk mund te diktoi se cfar cmimesh duhet te ofrojn kunderkandidatet ne oferten e tij.Pretendimi juaj ankimor ne kete pike eshte i pabazuar.

Sqarim ne pretendimin ankimor 3

Pretendimi juaj ankimore se "noterimi" -vertetimi i kopjes nga origjinali i ofruar per certifikaten e Sigurise dhe Shendetit ne pune per ing Ilir Meleqi nuk perputhet me certifikaten ne fjale eshte i pabazuar ngase ne pjesen VERTETIM I KOPJES NGA ORIGJINALI shume kjarte eshte cekur nga ana e noterit se citojme:"**Vertetoj se kopjet e bashkangjitura perputhen ne cdo aspekt me origjinalin ,pjesa integrale e te cilit origjinal ka gjithesejt nje flete dhe nje faqe ne nje ane dhe vertetuar nje here .....**" perfundon citati.Pretendimi juaj ankimor ne kete pike eshte i pabazuar.

Mendimi i Zyrtarit pergjegjes te Prokurimit

Ne si zyrtar pergjegjes i prokurimit pas kerkeses per rishqyrtim te aktivitetit te prokurimit "Rregullimi i hapsires publike te QMF-SE dhe kompleksi 300 ne rruget 28 nentori dhe Kuvendi i Lezhes ne Fushe Kosove ", vleresojme se kerkesa e OE"Valdrini " shpk eshte e pa bazuar dhe mbetet ne fuqi vendimi i AK qe kryerjen e puneve ne projektin ne fjale ta kryej OE GOE " AAB Construction" shpk & "Construmax" shpk .

Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit nga provat e prezantuara me larte vendosi si ne dispozitiv te keti vendimi.

Keshilla juridike:

Kunder keti vendimi pala e paknaqur me ankese mund ti drejtohet OSHP-se sipas ligjit ne fuqi

Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit i (AK)

_____